



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /  
Ministry of Culture, Youth and Sports

Prishtinë, Shtator 2023

## THIRRJA PËR PROJEKT-PROPOZIMET KULTURORE 2023

### ART DHE KULTURË

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), në fushën e artit dhe kulturës për vitin 2023, rendit ndër prioritetet programore: fuqizimin e rolit të skenës së pavarur kulturore në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike, rritjen e cilësisë së krijimtarisë artistike, identifikimin dhe mbështetjen e talentëve të rinj, aktivizimin e të rinjve në vendimmarrje dhe aktivitete të fushës së artit dhe kulturës, rrjetëzimin dhe promovimin e produktit vendor kulturor si produkt konkurrues në tregun ndërkombëtar të industrisë kreative.

Në funksion të prioritetit programor, thirrja për projekt-propozimet kulturore që mbulon fushën e artit dhe kulturës, synon mbështetjen e projekt-propozimeve të OJQ-ve dhe Individëve që zhvillohen në Republikën e Kosovës apo në shtetet ku është e koncentruar diaspora gjatë dhe përtej vitit fiskal 2023, deri në përfundimin e aktiviteteve sipas propozimeve të pranuar, të cilët përmbushin objektivat e përgjithshme si në vijim:

- Ngritja e cilësisë së krijimtarisë artistike dhe promovimi, pasurimi dhe diversifikimi i jetës kulturore nëpërmjet aktiviteteve gjithëpërfshirëse në fushën e artit dhe kulturës në Republikën e Kosovës;
- Fuqizimi i koordinimit dhe partneritetit ndërmjet institucioneve të kulturës dhe shoqërisë civile përmes fuqizimit të skenës së pavarur kulturore dhe nxitjes së akterëve të rinj që veprojnë në fushën e kulturës;
- Nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën kulturore brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, me theks te fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara;
- Zhvillimi i turizmit kulturor nëpërmjet organizimeve kulturore dhe artistike;

- Organizimi i aktiviteteve që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes për artin dhe kulturën e komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Kosovë.

Projekt-propozimet e zhvilluara në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe specifike duhet të synojnë gjithëpërfshirjen duke siguruar përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të komunitetit në aktivitetet përkatëse të projekt-propozimit, në veçanti të rinjtë, të moshuarit, vajzat dhe gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin LGBTIQ, komunitetet pakicë, etj.

#### **Kush mund të aplikojë:**

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës të profilizuara në fushën e artit dhe kulturës, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;
- Individët shtetas të Republikës së Kosovës apo shtetas të huaj pjesëtarë të diasporës kosovare, të profilizuar në fushën e artit dhe kulturës, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

#### **Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të të janë si në vijim:**

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora sipas legjislacionit ekuivalent për regjistrimin e organizatave jo-për-përfitim në vendin përkatës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-të e diasporës të regjistruara në vendin e huaj;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikantit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Staf i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në pozita të larta drejtuese në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (dokumenti dorëzohet nga përfituesi me rastin e nënshkrimit të kontratës);
- Në rast që OJQ-ja ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike;
- Përfaqësuesit e OJQ-ve aplikante nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë kuadër të kësaj thirrjeje publike.

**Kriteret e veçanta për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e artit dhe kulturës, me përvojë të dëshmuar në organizim të aktiviteteve artistike dhe kulturore. Në vlerësim mund të konsiderohet edhe përvoja individuale e anëtarëve të organizatës nëse OJQ-ja është e themeluar rishtazi;
- Të ofrohet lista e aktiviteteve dhe projekteve të realizuara gjatë dy vitet e fundit, ku përfshihen: titulli i projektit, periudha e zbatimit, buxheti i projektit dhe donatori (dokumenti nuk duhet të përmbajë fotografi);
- Të integrojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm të projektit në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike (Në vijat buxhetore të projektit të përfshihet edhe aktiviteti i auditimit të jashtëm);
- Të integrojnë komponentën e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve rreth artit dhe/apo kulturës në projekt-propozimin përkatës.

**Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT të janë si në vijim:**

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora (kopja e leternjoftimit, pasaportes ose dokument tjetër që dëshmon posedimin e shtetësisë);
- Në rast se individi ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikantit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në pozita të larta drejtuese në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Individët nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike;
- Individët nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si përfaqësues të OJQ-ve në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

**Kriteret e veçanta për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Duhet të jenë të profilizuar në fushën e artit dhe kulturës, me përvojë të dëshmuar në organizim të aktiviteteve artistike dhe kulturore;
- Të ofrohet lista e aktiviteteve dhe projekteve të realizuara gjatë dy vitet e fundit, ku përfshihen: titulli i projektit, periudha e zbatimit, buxheti i projektit dhe donatori (dokumenti nuk duhet të përmbajë fotografi);

- Të integrojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm të projektit në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike (në vijat buxhetore të projektit të përfshihet edhe aktiviteti i auditimit të jashtëm);
- Të integrojnë komponentën e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve rreth artit dhe/apo kulturës në projekt-propozimin përkatës.

### **Dokumentet obligative për aplikim për OJQ:**

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme si në vijim:

- Formulari i Aplikacionit për projekt (Dokument i thirrjes publike);
- Formulari i Propozim buxhetit (Dokument i thirrjes publike);
- Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë (Dokument i thirrjes publike);
- Formular i deklaratës se partneritetit, nëse aplikohet (Dokument i thirrjes publike);
- Forma e deklaratës se projekteve te financuara nga fondet publike në dy vitet e fundit (Dokument i thirrjes publike);
- Certifikata e regjistrimit dhe certifikata e numrit fiskal e OJQ-së (lëshuar nga Departamenti i OJQ-ve, ATK);
- Vërtetimi që nuk ka obligime financiare ndaj ATK (dokumenti i lëshuar nga ATK dorëzohet nga përfituesi me rastin e nënshkrimit të kontratës);
- Lista e aktiviteteve dhe projekteve të realizuara gjatë dy vitet e fundit (Dokument i OJQ-se aplikuese);
- Kopja e letënjoftimit ose pasaportës së aplikantit.

### **Dokumentet e nevojshme për individë:**

- Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (Dokument i thirrjes publike);
- Formulari i Propozim buxhetit (Dokument i thirrjes publike);
- Formulari i deklaratës për financimit të dyfishtë (Dokument i thirrjes publike);
- Formular i deklaratës se partneritetit, nëse aplikohet (Dokument i thirrjes publike);
- Forma e deklaratës se projekteve te financuara nga fondet publike në dy vitet e fundit (Dokument i thirrjes publike);
- Kopja e letënjoftimit ose pasaportës;
- CV-ja e aplikuesit që duhet të përfshijë përgatitjen profesionale.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

### **Shkalla e mbështetjes:**

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 25,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: N/A Euro

**Vlerësimi i projekt-propozimeve** do të zhvillohet në dy faza:

**1. Vlerësimi administrativ** - që identifikon nëse aplikanti ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

**2. Vlerësimi përmbajtësor** - që vlerëson nëse:

- Aplikuesi është i profilizuar në fushën e artit dhe kulturës;
- Aplikuesi ka përgatitjen dhe kapacitetet e nevojshme për zbatimin e projektit;
- Aplikuesi ka aplikuar parimet e qeverisjes së mirë në zbatimin e programit respektiv në vitet paraprake;
- Aplikuesi ka paraparë zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të prezantuar në këtë thirrje publike;
- Projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrjeje publike;
- Projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- Aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pakompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

#### **Aplikimi:**

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në web-faqen e MKRS-së: [www.mkrs-ks.org](http://www.mkrs-ks.org). Aplikantët duhet të aplikojnë në thirrje vetëm përmes postës elektronike në email adresën: [thirrjet.mkrs@rks-gov.net](mailto:thirrjet.mkrs@rks-gov.net). Projekt-propozimet e shtypura në formë fizike nuk do të pranohen për shqyrtim.

Titulli që duhet shënuar në subjekt të emaili-it:

Thirrja Art dhe Kulturë\_Emri i OJQ-së/ individit

#### **Afati për aplikim:**

Afati i fundit për aplikim është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 9 Tetor 2023.

#### **Më shumë informacione rreth thirrjes publike:**

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [jehona.shyti@rks-gov.net](mailto:jehona.shyti@rks-gov.net), jo më vonë se pesë ditë para mbylljes së ftesës publike.